



C.nr.473/12

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti Pergjithshem-Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtësen Minire Krasniqi, ne ceshtjen juridike sipas padise se apditeses [REDACTED], me seli ne ferizaj te cilen e perfaqeson me autorizim [REDACTED] nga Ferizaj kunder te paditurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Ferizaj, per borxh, ne seancën e mbajtur me date me date 26.08.2014, ne mungese te te paditurit, me date 01.09.2014, merr kete:

AKTGJYKIM

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses [REDACTED] dhe **OBLIGOHET** i padituri [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Ferizaj, që paditëses në emër të pagesës së borxhit për shfrytëzimin e energjisë elektrike t'ia paguan shumën prej 5,196.92 €, se bashku më kamatën e cila do të llogaritet nga dita e ushtrimit te padise (17.07.2012), sipas lartesisë qe llogarisin bankat per deponimet e afatizuara per periudhe njevjecare, nga qytetetaret si dhe shpenzimet e procedures kontestimore en shume prej 70.00€, te gjitha keto en afat prej 15 ditesh, pas plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi, nen kerconimin e eprnabrimit me dhune.

OBLIGOHET paditësja që të bëjë pagesëne taksës gjyqësore për aktgjykim në shumë prej 50.00€, pas pranimit të ketij aktgjykimi.

Arsyetimi

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, ka pretenduar se i padituri i ka ngelur borxh paditëses, në emër të mospagesës së shërbimeve të energjisë elektrike që ka shfrytëzuar, per periudhën nga dhjetor te vitit 2003 e deri me date 20.05.2012.

Ka shtuar se i padituri ka pranur rregullisht shërbimet dhe për tyë njehta është faturuar, ndërsa i njehti nuk ka përmbuhsur detyrimet financiare për shfrytëzimin e energjisë elektrike ndaj paditëses.

I ka propozuar gjykatës që të aprovon kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar se bashku me kamaten dhe shpenzimet e procedures.

I padituri, ndonese ka qene i ftuar me rregul per seancen e dates 26.08.2014, I njehti nuk ka prezantuar.

Ne kundërshtimin e tij paraqitur me shkrim, i njehti nuk ka kontestuar borxhin ndaj paditeses, pork a potencuar se per shkak te gjendjes se rende ekonomike nuk mund te perballoj pagesen e broxhit te tille.

Gjykata me qellim te vertetimit te gjendjes faktike te ceshtjes, ne pajtim me nenin 7.1 te LPK-se, ka bere administrimin e provave si vijon:

Fatura 20.05.2012 kartela e konsumatori per te padituri dt.25.08.2014



Gjykata pas admisnitrimit te provave , ne kuptim te nenit 8 te LPK-, ka bere shqyrtimin dhe vleresimin e tyre vec e vec si dhe te nderlidhura ne teresi ndermjet veti, kur ka gjetur se kerkespadia e paditeses eshte e bazuar.

Gjykata në këtë çështje juridike, nga gjendja e fakteve dhe provave te ceshtjes, ka gjetur sit e vertetuar faktin se ne mes paleve ndergjygjese ka ekzistuar marredhenia kontraktuale, per ofrimin e sherbimeve- marrjen e sherbimeve, te furnzimit me energji elektrike, me cka rrjedhimisht ne mes paleve ndergjygjese jane krijuar te drejta-detyrime per te permbushur te njejtat si pasoje e kesaj marredhenie.

Gjykata gjithashtu ka vertetuar faktin se i padituri I ka ngelur borxh paditeses shumen kontestuese, kete mbi bazen e fatures qe ka pezantuar paditesja , nga ku mund te veretohet se i padituri I ka ngelur borxh paditeses shumen objekt kontesti per periudhen dhjetor 2012 deri me daten e ushtrimit te padise.

I apdituri edhe ne theksimet e paraqitura ne kundershiti ka pranuar borxhin ne fjale si ekzistence, pork a paraqitur kundershitime qe nderlidhen me gjendjen e rende ekonomike te tij.

Gjykata ka obliguar te paditurin per kompensimin e shpenzimeve paditeses ne abze te nenit 542.1 te LPK-se, ndersa paditesen per pagesen e taksës gjyqesore per aktgjykim ne baze te UA te KGJK-se nr.2008-2.

Per kamaten gjykata ka vendosur ne baze te nenit 277 lidhur me nenin 186 te LMD-se.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ


C.nr.473/12 date 01.09.2014

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
DËLUKA JË PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC



11. 2014



Keshilla juridike: Kunder ketij agjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te kopjes se tij, ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate.